



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.93, datë 09.05.2023

PËR

**“CAKTIMIN E ZOTIT YLLI PJETËRNIKAJ NË DETYRËN E
PROKURORIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË
PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, NËPËRMJET
PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90 pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenet 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e zotit Ylli Pjetërnikaj në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin vakant Nr.1, shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.332, datë 19.12.2022.
2. Të përfundojë procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për kandidatët Albert Kuliçi, Albjona Papajani, Alma Bramo, Bledar Bejko, Elidon Hysenaj, Erida Visoçi, Mediana Meta dhe Urim Buci.
3. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Ylli Pjetërnikaj, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe të gjithë kandidatët e tjerë.
5. Ky vendim hyn në fuqi në datë 15.05.2023, dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 09.05.2023.



KRYETAR
Alfred Balla

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurrihan Seiti

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

